

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA NË VITI, Departamenti përgjithshëm penal,** duke vendosur sipas gjyqtarit Skender Shefkriu me asistenten Ajshe Bekteshi në çështjen penale të akuzuarit S.A. nga f. B., Komuna V., te cilin e perfaqson av. A.I. sipas detyres zyrtare, për shkak të veprës penale lajmrim apo kallëzim i rrem nga neni 390 paragraf 4 të KPRK-së, sipas aktakuzës të PTHSH nga Gjilani, PP.II.nr.21810/2015, të datës 09.12.2015, të përfaqësuar nga I.U., pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më 25.01.2017 shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari **S.A.** nga babai A. dhe nenes R., e vajzerise Sh., i lindur me “data e lindjes...”: 31.07.1978, në fsh. B, Komuna e V. ku edhe tani jeton, ka te kryer shkollen fillore, i punsuar në “K...”, i martuar, babë i dy fëmijeve me gjendje te mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës se Kosoves.

### Ë S H T Ë F A J T O R S E P S E

Më datë .././2017, rreth orës ..:.., i akuzuari S.A., me qëllim të pëftimit të kunderligjshme pasuror per vete, me dashje ka vënë në lajthim zyrtaret policor duke bërë lajmërim të rrem kinse me dt. .././2014, rreth ores ..:.. ne V. që perms telefonit ka thirrur në telefonin zyrtar në stacionin policor në Viti,ne rr.”D e K” ishte grabitur nga personat e panjohur nen kercenimin e thikes dhe ate nje shumë te hollave prej 700Euro te cilet kishin ikur ne drejtim te panjohur, ne kete menyrr i pandehuri me veprimet e vet ka lajmeruar rrejshem per një veper penale, e cila ndjeket sipas detyres zyrtare per te cilen e ka ditur se ajo veper ne fakt nuk eshte kryer.

Me çka ka kryer veprën penale, **lajmërimi apo kallëzimi i rrem nga neni 390 paragrafi 4 të KPRK-së.**

-Andaj Gjykata në bazë të nenit 41, 46, 51, 73, 74, e 75 të KPRK-së, dhe neni 365 të KPPRK-së,

### E G J Y K O N

**Dënim me gjobë në shumën prej 300.00 (treqindeuro)**

**Dënimi i shqiptuar do të paguhet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi i shqiptuar do t’i zëvendësohet me burg në kohëzgjatje prej 15 ditësh, duke llogaritur nga 20€ për një ditë të kaluar në burg.**

Obligohet i akuzuari qe ne emer te shpenzimeve procedurale te paguaj shumen prej 20 euro pas plotfuqishmerise se aktgjykimit.

### A r s y e t i m

PTHSH nga Gjilani me aktakuzat PP.II.nr.2180/2015, të datës 09.12.2015, e ka akuzua S.A., nga f. B, për shkak të veprës penale lajmrim apo kallëzim i rrem nga neni 390 paragraf 4 të KPRK-së.

**Prokurorja I.U.** në fjalën përfundimtare ka deklaruar: Mbetem në tërësi pranë aktakuzes se paraqitura dhe propozimeve që e njejta i permban pasi që gjendja faktike në këto çështje penale juridike u vertetua edhe me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pranim ky që është në përputhshmeri të plotë edhe me provat tjera të cilat janë propozuar për tu shtjelluar si prova për ta vertetuar të drejtën në mënyrë të plotë gjendjen faktike. Me rastin e matjes së shqiptimit të denimit, t'i merren parasysh të gjitha rrethanat; si ato rënduese po ashtu edhe ato lehtësuese ndërsa në anën tjetër edhe faktin se i pandehuri ishte korrekt para gjykatës dhe e pranoi fajsinë.

**Fjala përfundimtare e mbrojtësit av.A.I.:** pasi që i mbrojturi im S.A.e pranon fajesin lidhur me aktuakuzen siq u lexuar me par, i dyshuar për veper penale lajmerim apo kallezim i rrem nga neni 390 paragrafi 4, të KPRK-së.

Mua nuk më mbetet gjë tjetër vetëm ti propozoj gjykatës që gjatë shqiptimit të denimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese siq është pranimi i fajësisë, pendimi i të dyshuarit, premtimi se më nuk do të kryej asnjë lloj veper penale. Është hera e parë që ballafaqohet me ligjen është baba i dy femijëve e duke pasur parasysh sjelljen e tij para kryerjes dhe pas kryerjes së veprës penale duke pasur parasysh këto rrethanat i propozoj gjykatës që të mbrojturit tim të ja shqiptoj një denim me të holla në kuadër të ligjit, i cili do të ishte në proporcion krahas veprës me të cilin dyshohet.

**Fjala përfundimtare të akuzuarit S.A. :** e ka përkrahur fjalën e avokatit të tij mbrojtës dhe ka shtuar se i kërkon falje të gjitha institucioneve, nuk e ka ditur se është aq vepër e rëndë, dhe është betuar se nuk do të përsërisë vepra të tilla e as tjera penale, dhe ka kërkuar nga gjykata që të i shqiptoj një denim sa më të butë.

Gjykata pas vlersimit të provave që gjinden në shkresat e lëndës e pasi që i akuzuari ka pranuar në tërësi veprën penale, pranimin e fajësisë e cila është bërë në përputhje me dispozitat e nenit 246 të KPRK-së, e që i vihet në barë Gjykata u përqendrua në vendosjen vetëm përkitazi me matjen dhe lartësinë e denimit konform nenit 74 të KPRK-së, dhe nenit 75 të KPK-së, kështu me rastin e caktimit të lartësisë së denimit Gjykata pati parasysh rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e denimit.

Si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, pendimin dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të këtij lloji e as të tjera, është hera parë që përballë me Ligjin dhe ka premtuar se tash e tutje nuk do të bie ndesh me ligjin, me gjendje të varfër ekonomike, është i sëmur nga sëmundja e gllaukomes dhe sëmundja depresive. Si rrethanë rënduese shkalla e përgjegjësisë penale.

Bindja e Gjykatës së denimi i shqiptuar është i ligjshëm, është në proporcion me veprën penale, përgjegjësinë penale të të akuzuarit dhe se me denimin e tillë të shqiptuar do të arrihet qëllimi i këtij denimi.

Nga të cekurat më lart u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN- DEGA NË VITI**

**P.nr. 708/2015**

**Me dt.25.01.2017**

**Asistentja,  
Ajshe Bekteshi**

**Gj y q t a r i,  
Skender Shefkiu**

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankes në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të Aktgjykimit, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmes të kësaj Gjykate.